



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-08/05

Prishtinë, më 23 dhe 24 qershor 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, por i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 93 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i përmbushjes së standardeve;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tokat bujqësore;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologjinë;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mjekësinë ligjore;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për duhanin;
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e gjuhëve;
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor;
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për grevat;
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën e dhënies së koncesioneve;
14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e

- anëtarëve të Agjencisë për Prokurim Publik;
15. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Rregullatorit të Energjisë;
 1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
 17. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Ankesa;
 18. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komision për Gatishmëri Emergjente;
 19. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për zëvendësimin e një anëtari të këtij komisioni;
 20. Miratimi i propozim-marrëveshjes për sigurinë e investimeve Kosovë-Turqi;
 21. Përgjigjja e ministrit Qemajl Ahmeti në pyetjen e deputetit Gazmend Muhaxheri lidhur me zbatimin e Ligjit për rrugët.

Në fillim të seancës, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që të hiqen nga rendi i ditës pikat e 15, 16 dhe 18.

Kryetari kërkoi të hiqej edhe pika e 8-të e rendit të ditës.

Kuvendi i miratoi kërkesat për heqjen nga rendi i ditës pikat 8, 15, 16 dhe 18.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje. Deputetët **Sadudin Berisha** dhe **Safete Hadërgjonaj** patën vërejtje në evidencimin e diskutimit të tyre në transkript, që u përmirësua sipas vërejtjeve të paraqitura.

2. Shqyrtimi i përmbushjes së standardeve për Kosovën

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, e paraqiti fjalën hyrëse lidhur me përmbushjen e standardeve për Kosovën.

Në vazhdim kryeministri theksoi se Qeveria e Kosovës bashkë me UNMIK-un Planin për standardet e ka shndërruar në projekt pune të saj, si dhe ka krijuar mekanizmat për realizimin e tyre.

Një ndër veprimet e para të ndërmarra në këtë periudhë ka qenë miratimi i standardeve prioritare. Pas miratimit, është bërë menjëherë organizimi i grupeve punuese, të cilat kanë marrë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e plotë të standardeve nëpër ministritë përkatëse.

Standardi i parë – funksionimi demokratik i institucioneve, iu besua Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

Standardi i dytë – sundimi i ligjit, iu besua Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Standardi i tretë dhe i katërt – liria e lëvizjes dhe kthimet e qëndrueshme Ministrisë së Pushtetit Lokal.

Standardi i pestë – ekonomia, iu besua Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Standardi i gjashtë – e drejta pronësore, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Trashëgimia kulturore iu besua Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Standardi i shtatë – dialogu, është në kuadër të Kryeministrit të Kosovës. Standardi i tetë – TMK-a është kompetencë e UNMIK-ut, nuk është në kuadër të kompetencave tona.

Secila nga këto grupe, çdo tri javë informon dhe raporton për progresin e arritur përpara shteteve anëtare të Grupit të Kontaktit, si dhe para faktorëve të tjerë ndërkombëtarë të kyçur në procesin e zbatimit të standardeve.

Në nivel komunal, Zyra e Koordinatorit të standardeve, bashkë me Ministrinë e Pushtetit Lokal, koordinon aktivitetet lidhur me zbatimin e standardeve. Në baza dymujore, ekipi i përbërë nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për standarde – viziton secilën komunë veç e veç dhe bën vlerësime të progresit në realizimin e standardeve në komunën përkatëse.

Në këtë periudhë janë arritur rezultate shumë të mira në zbatimin e standardeve posaçërisht të atyre prioritare. Nga 67 standarde prioritare, gjysma e tyre janë plotësuar tërësisht, kurse të gjitha standardet tjera janë në fazën përfundimtare të implementimit.

Të arriturat në përmbushjen e standardeve kanë shënuar progres në këto fusha: Në funksionimin i Institucioneve demokratike; në miratimin e ligjeve, të kërkuara sipas standardeve prioritare; në respektimin e dygjuhësisë; në strategjinë për kthimin e personave të zhvendosur; në punësimin e minoritarëve në institucionet qendrore dhe në ato lokale, që përbën 10.2% të të gjithë të punësuarve; në fushën e mediave; në Shërbimin Policor të Kosovës; në gjykatat e Kosovës; incidentet ndëretnike, kanë shënuar rënie të vazhdueshme dhe tanimë gati një vit në Kosovë nuk kemi pasur ndonjë incident serioz ndëretnik.

Brenda 7 mujorit të fundit janë bërë dy vlerësime teknike dhe politike të standardeve, që kanë qenë vlerësime pozitive dhe reale.

Vlerësimi i fundit, i Këshillit të Sigurimit, i mbajtur më 27 maj ka qenë pozitiv për institucionet e Kosovës dhe punën e tyre.

Një ndër të arriturat më të mëdha në këtë proces është edhe vendimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për fillimin e vlerësimit gjithëpërfshirës të standardeve prioritare.

Sekretari i përgjithshëm i OKB zoti Anan ka emëruar ambasadorin Kai Aide emisar të posaçëm për vlerësimin gjithëpërfshirës të standardeve. Ne kemi përshëndetur këtë vendim dhe ne besojmë se vlerësimi i ambasadorit Aide do të jetë real dhe si i tillë do të hapë rrugën për fillimin e procesit të definimit të statusit final të Kosovës.

Pas fjalës së kryeministrit, kryetari e hapi debatin parlamentar për shqyrtimin e standardeve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Programin e Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylja, Veton Surroi, Mahir Jakxhilar, Fatmir Sejdiu, Emrush Xhemajli, Hajredin Kuçi, Sabri Hamiti, Sabit Rrahmani, Teutë sahatçiu, Xhezair Murati, Enver Hoxha, Fadil Geci, Zylfi Merxha, Saala Ahmeti, Gazmend Muhaxheri, Qibrije Hoxha, Ferid Agani, Ramadan Kelmendi, Berat Luzha, Ylber Hysa, Nimon Alimusa, Harejdin Hyseni, Besa Gaxheri, Kolë Berisha, Xhevdet Neziraj, Xhavit Haliti, Fatmire Kollçaku, Sanije Alaj, Zef Morina, Agim Krasniqi, Xhevat Bislimi,**

Nazim Jashari, Ramdan Musliu dhe Ragip Zekolli, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këtë

Përfundim:

1. Autorizohet Kryesia e Kuvendit ta hartojë një deklaratë për përmbushjen e standardeve për Kosovën.

Kryetari e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 15:20 minuta.

Më 24 qershor 2005

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, por i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 84 deputetë.

Seanca i vazhdoi punimet me shqyrtimin e projektligjeve.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, secilin veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion dhe të deputetit Ferid Agani.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----82;
Kundër----- 1;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tokat bujqësore

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----83;

Kundër----- 1;

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për tokat bujqësore.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqërinë informatike

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Bajgush Xhemajli, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri... i informoi deputetët lidhur me vështërsitë që kishte pasur ky komision gjatë shqyrtimit të këtij projektligji. Teksti i këtij projektligji duhet të lekturohet.

Deputetët Fatmir Sejdiu dhe Hajredin Kuçi patën vërejtje për emërtimin e këtij projektligji.

Kryetari propozoi që ky projektligj t'i kthehet propozuesit.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi

V E N D O S I:

1. Projektligji për shërbimet e shoqërisë informatike shtyhet për seancën e radhës.
2. Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri dhe Telekomunikacion, në bashkëpunim me propozuesin e projektligjit, ta definojnë emërtimin e tij, si dhe të lekturohet ai .

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Bujar Dugolli, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Dugolli shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji është i ndarë në tre kapituj dhe përmban gjithsej 38 nene.

Projektligji rregullon, në mes tjerash, çështjen e deponimit kontraktues dhe shitblerjen e palujtshmërive, sistemin dhe koncesionin, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me transferin dhe riinvestimin e fitimeve.

Sa i përket sigurisë juridike, duhet të theksohet se ligji iu garanton investitorëve të huaj të drejtën në kompensim në rast të humbjes materiale, gjatë situatave të jashtëzakonshme, ose nëse humbjet e shkaktuara kanë qenë rezultat i aktiviteteve joligjore të autoriteteve shtetërore.

Kreu i dytë i Projektligjit rregullon çështjen e kontratës për investime, si dhe evidencimin e investimeve të huaja, që realizohet nga Agjencia për promovimin e investimeve. Kjo agjenci do të jetë organ i formuar në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Veprimtaria kryesore e saj është promovimi i investimeve dhe mbështetja e personave fizik dhe juridik, vendor ose të huaj, me rastin e përzgjedhjes dhe realizimit të projekteve investuese në Kosovë.

Gjithashtu, Projektligji lejon edhe zbatimin e masave stimulative, në raste të jashtëzakonshme, me qëllim të zhvillimit sa më të qëndrueshëm ekonomik, punësim më të madh ose zhvillim të rajoneve më pak të zhvilluara ekonomikisht.

Miratimi i këtij projektligji nënkupton edhe plotësimin e standardit të 5-të për ekonominë

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Dugolli, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Bajrush Xhemajli, Teutë Sahatçiu, Gjylnaze Sylja, Xhezair Murati, Ramadan Kelmendi dhe Ibush Jonuzi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 71;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për investimet e huaja. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri...- Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologjinë

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit. **Ministri Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij. Në vazhdim, ministri Dugolli shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Kapitulli i parë përcakton qëllimin dhe objektin e rregullimit.
Kapitulli i dytë përcakton fushëveprimin e organeve legale të metrologjisë në Kosovë.
Kapitulli i tretë përcakton njësitë matëse ligjore, përdorimi i të cilave është tanimë i rregulluar me ligjin për njësitë matëse, që është në fuqi në Kosovë
Kapitulli i katërt rregullon çështjen e metrologjisë shkencore
Kapitulli i pestë rregullon çështjen e metrologjisë industriale, fushën në të cilën kryhet kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse.
Në kapitullin e gjashtë përcaktohet mënyra e financimit të Institutit të Metrologjisë së Kosovës.
Në kapitullin e shtatë rregullohet puna e inspektimit metrologjik. Më konkretisht, kjo ka të bëjë me rregullimin e aktivitetit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Dugolli, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nurishahe Hula, Afrim Arzuallxhiu, Genc Gorani, Mazllun Kumnova, Mahir Jakxhillar, Hatixhe Hoxha, Ibush Jonuzi, Teutë Sahatçia, Fadil Kryeziu, Sabri Hamiti dhe Sala Berisha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 77;
Kundër----- 1;
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për metrologjinë. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri...- Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për duhanin

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, Astrit Ajeti, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri Ajeti shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji është përpiluar në dhjetë kapituj me këtë përmbajtje.

Kapitulli i parë përfshin dispozitat e përgjithshme, që mbështesin përpjekjet e shoqërisë për të zbutur dhe parandaluar dëmet për shëndetin e popullatës, që shkakton tymosja dhe përgatitja e duhanit.

Kapitulli i dytë përfshin përkufizimet, në të cilin jepen përkufizimet për bimën, prodhimet, përbërësit e duhanit, pirjen, pasojat, masat dhe për vendet publike në të cilat kufizohet ose ndalohet pirja e duhanit.

Kapitulli i tretë përfshinë kushtet e domosdoshme për prodhimin dhe qarkullimin e cigareve.

Kapitulli i katërt përfshin masat për zvogëlimin dhe kufizimin e pirjes së duhanit, ku përcaktohet ndalimi i reklamimit dhe eksponimit të palejuar të duhanit.

Kapitulli i pestë rregullon shitjen e prodhimeve të duhanit.

Kapitulli i gjashtë përkufizon vendet ku ndalohet pirja e duhanit dhe definimi i hapësirave për duhanxhinj.

Kapitulli i shtatë përmban masat preventive kundër pirjes së duhanit.

Kapitulli i tetë përcakton organet për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Kapitulli i nëntë përcakton dispozitat ndëshkuese ku persona juridik ose fizik prodhojnë, shesin, ofrojnë apo pinë duhan në kundërshtim me këtë ligj dhe

kapitulli i dhjetë përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri Ajeti, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Niman Alimusaj, Zahrije Isufi, Zylfije Hundozi, Fatmire Kollçaku, Shpresa Murati, Sanije Alaj, Ilaz Pireva, Sala Berisha, Mark Krasniqi, Fadil Kryeziu, Nurishahe Hulaj, Remzije Nimani dhe Ferid Agani**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 70;

Kundër----- 2;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për duhanin. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Punë, Mirëqeni Sociale dhe Shëndetësi - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

9. Shqyrtimi i parë i projektligjit për përdorimin e gjuhëve

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, Mark Komani, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri Komani shpjegoi strukturën e këtij projektligji. Ky projektligj është strukturuar si vijon:

Pjesa e parë, që përmban nenet 1 deri 4 – është pjesa më e rëndësishme. Në të është përcaktuar se cilat gjuhë janë gjuhë zyrtare të nivelit qendror dhe lokal në Kosovë. Përveç gjuhëve shqipe dhe serbishte, që janë gjuhë zyrtare në Kosovë, është siguruar që edhe gjuhëve të minoriteteve t’u jepet statusi i gjuhëve zyrtare në nivel të komunave.

Pjesa e dytë e Projektligjit përfshin dispozitat ligjore lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore të Kosovës. Janë paraparë të drejtat e përdorimit të gjuhëve, varësisht nga institucionet për të cilat bëhet fjalë.

Një pjesë e këtij projektligj përcakton rregullat e përdorimit të gjuhëve në komuna.

Neni 13 përcakton rregullat e përdorimit të gjuhëve në ndërmarrjet publike.

Në një pjesë mjaft të gjerë është rregulluar e drejta e përdorimit të gjuhëve në procedurën penale dhe procedurat të tjera gjuhësore

Përdorimi i gjuhëve në arsim, është një kapitull i veçantë në të cilin përveç gjuhëve zyrtare për mësim në arsimin publik është përcaktuar e drejta e komuniteteve që mësojnë në gjuhën e tyre amtare në shkollat publike

Pjesa e tretë e Projektligjit, në zbatim të tij ka paraparë që Qeveria e Kosovës të themelojë Komisionin e gjuhëve, që do të sigurojë zbatimin e ligjit në tërë territorin e Kosovës.

Në kapitullin shkeljet dhe sanksionet – është përcaktuar me nenin 36 që Ministria e Shërbimeve Publike të nxjerrë udhëzimin administrativ në mënyrë që t’i përcaktojë këto sanksione.

Në pjesën e katërt – dispozitat kalimtare, në nenin 37 është përcaktuar që institucionet e Kosovës në punën e tyre, në kontaktet dhe në dokumentet zyrtare gjatë mandatit të administratës së përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara ta përdorin gjuhën anglishte.

Është paraparë afati gjashtëmujor për hartimin e udhëzimeve administrative për zbatimin e këtij ligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri Komani, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Jonuz Kastrati, Enver Hoxha, Myrvete Ndreshaj, Mahir Jakxhillar, Ylber Hysa, Emrush Xhemajli, Rifat Krasniq, Nuriye Doçi, Nuran Malta, Xhezair Murati, Sala Ahmeti, Zylfi Merxha, Ramadan Kelmendi, Xhevat Bislimi, Fetah Berisha, Hajredin Hyseni dhe sabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 49;

Kundër----- 18;

Abstenime----- 7.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për përdorimin e gjuhëve. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspektoratin shëndetësor

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, Astrit Ajeti, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Dispozitat themelore të këtij projektligji përmbajnë detyrat dhe qëllimet e inspektoratit shëndetësor; funksionet e inspektoratit shëndetësor.

Inspektorati shëndetësor përcaktohet si organ administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë, që me akt të veçantë përcakton organizimin e tij brenda Ministrisë.

Kryeinspektorit shëndetësor i jepet detyrë që të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe të vendimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e tyre.

Veprimtaria e Inspektoratit shëndetësor do të financohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë.

Projektligji u mundëson inspektorëve shëndetësor qasje në inspektimin e institucioneve shëndetësore.

Projektligji parasheh kushtet për ta ushtruar detyrën e inspektorit shëndetësor.

Ndalimi i ushtrimit të detyrës së inspektorit shëndetësor mund të ndodhë nëse i shkelë dispozitat ligjore.

Procedura e ankesës. parasheh rastet kur pala nuk është e kënaqur me vendimet e shqiptuara nga ana e inspektorit shëndetësor.

Dispozitat kalimtare parashohin që Ministria e Shëndetësisë obligohet të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri Ajeti, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naim Jerliu, Zahrije Isufi, Zylfije Hundozi, Fatmire Mulhaxha, Shpresa Murati, Ferid Agani dhe Ilaz Pireva**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 67;

Kundër----- 5;

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Punë, Mirëqeni Sociale dhe Shëndetësi - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë

këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për grevat

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ibrahim Selmanaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Me këtë projektligj institucionalizohet dhe legalizohet organizimi dhe mbajtja e grevave si një nga të drejtat themeloret të të punësuarve në njërën anë krijimin e bazës ligjore me të cilën përcaktohet kjo e drejtë, në anën tjetër.

Me dispozitat e këtij projektligji rregullohen të drejta te të punësuarve për t'u organizuar në grevë: koha, vendi dhe rrethanat kur organizohet ajo, të drejtat dhe përgjegjësitë e organizatorëve dhe pjesëmarrësve në grevë si dhe kushtet për ndërprerjen e saj.

Përmes këtij projektligji synohet të arrihen këto objektiva:

- mbrojtja e të drejtave ligjore për organizatorët dhe pjesëmarrësit e grevës;
- rregullimi i raporteve, të drejtave dhe përgjegjësiive të punëdhënësit dhe punëmarrësit grevist;
- deklarimi i lirë i punëtorëve për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës;
- deklarimi i lirë dhe i drejtë i grevistëve përkitazi me veprimet e kundërligjshme të punëdhënësit dhe dukuritë tjera negative;
- plotësimi i kërkesave ligjore punëtorëve si rezultat i parashtrimit të kërkesave publike me rastin e organizimit dhe mbajtjes së grevës;
- përmbushja e kërkesave ligjore të punëtorëve që nuk janë realizuar sipas legjislacionit në fuqi;
- ndalimi i çdo veprimi të kundërligjshëm ndaj punëmarrësve për shkak të pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes në grevë.

Zbatimi i këtij ligji në praktikë nuk paraqet implikime buxhetore.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Selmanaj, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nafije Berisha, Gani Koci, Mazllun Kumnova, Ylber Hysa, Gjylishene Berisha, Fetah Berisha dhe Nexhat Rexha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63;
Kundër----- 5;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për grevat. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Punë, Mirëqeni Sociale dhe Shëndetësi - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën e dhënies të koncesioneve

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Bajrush Xhemajli, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, tha se Ligji për koncesione i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 korrik 2004 nuk është shpallur nga PSSP-ja, por i është kthyer Kuvendit për rishqyrtim. Komisioni e ka bërë shqyrtimin e tij në bazë të komenteve dhe propozimeve të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut dhe të Shtyllës së katërt të UNMIK-ut dhe ka ardhur në përfundim se kërkesat e Zyrës ligjore të UNMIK-ut dhe Shtyllës së UNMIK-ut janë për ndërrim të konceptit në tërësi, atëherë Komisioni ka hartuar një Projektligj të ri, i cili në pika thelbësore të trajtuara dallon konceptualisht nga ligji i mëparshëm për koncesione të cilin e patëm miratuar në Kuvend. Në vazhdim, deputeti Xhemajli arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, qëllimin dhe objektivat që do të realizohen, si dhe strukturën e tij.

Pjesa e parë përmban përkufizimet më të rëndësishme të termave juridike të përdorura në ligj, qartëson raportin ndërmjet ligjit për koncesione dhe Ligjit për prokurim publik.

Në pjesën e dytë rregullohet procedura e përzgjedhjes koncesionare, duke përfshirë aty fazën e paraseleksionimit si dhe përzgjedhjen në bazë të një propozimi të kërkuar nga organi përkatës publik.

Pjesa e tretë, ka të bëjë me kontratën e koncesionit, përmbajtjen e domosdoshme të saj si dhe çështjet e ndërlidhura me pronësinë, servitutet, mjetet siguruese dhe bartjen e kontratës.

Pjesa e katërt, rregullon modalitetet e kohëzgjatjes, të vazhdimit dhe shkëputjes së kontratës së koncesionit.

Pjesa e pestë, ka të bëjë me zgjidhjen e kontesteve; dhe

Pjesa e gjashtë, me ushtrimin e mbikëqyrjes ligjore nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga deputeti Xhemajli, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir rexhepi, Hatixhe Hoxha, Xhevdet Neziraj, Teutë Sahatçia, Milazim Haliti, Sabri Hamiti dhe Nerxhivane Dauti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 62;
Kundër----- 7;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për procedurën e dhënies të koncesioneve. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

13. Shqyrtimi i propozim – Marrëveshjes për promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve Kosovë – Turqi

Ministri Bujar Dugolli, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi Marrëveshjes për promovimin e ndërsjellë dhe mbrojtjen e investimeve Kosovë – Turqi.

Kuvendi, pas shqyrtimit të kësaj propozim-marrëveshje, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Marrëveshja për promovimin e ndërsjellë dhe mbrojtjen e investimeve Kosovë – Turqi.
2. Marrëveshja për promovimin e ndërsjellë dhe mbrojtjen e investimeve Kosovë – Turqi i dërgohet PSSP-së për nënshkrim

14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit udhëheqës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozim-vendimi, mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit udhëheqës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

I. Në Bordin udhëheqës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale emërohen këta kandidatë:

1. Nagip Zeka, inxhi. dipl. i metalurgjisë dhe
2. Blerim Baruti, prof. Dr. në Fakultetin e Xehetarisë-Metalurgjisë në Mitrovicë.

15. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit parlamentar

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozimi, mori këtë

V E N D I M

1. Në Komisionin për Gatishmëri Emergjente, në vend të z.Arsim Bajrami, emërohet deputeti Xhevat Bislimi, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës.

16. Shqyrtimi i propozimit të Partisë Demokratike Serbe dhe të Komisionit për Komunitete për zëvendësimin e një anëtari në këtë komision dhe në Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozimi, mori këtë

V E N D I M

2. Në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në vend të z. Sllavisha Petković emërohet deputeti Sasha Gjokiq.
2. Në Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në UE në vend të z. Sllavisha Petković emërohet deputeti Sasha Gjokiq.

17. Përgjigja e ministrit Qemajl Ahmeti në pyetjen e deputetit Gazmend Muhaxheri lidhur me zbatimin e Ligjit për rrugët

Ministri Qemajl Ahmeti, nuk ishte i pranishëm në seancë, por ishte përgjigjur me shkrim në pyetjen e deputetit Gazmend Muhaxheri.

Deputeti Gazmend Muhaxheri tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen e ministrit Ahmeti, prandaj kërkon përgjigje gojore në seancën e radhës të Kuvendit.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 19:15 minuta.

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**